



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Vushtrrisë

Opština Vučiteri – Municipality of Vushtri

DREJTORIA KOMUNALE PËR SHËNDETËSI

RAPORT PUNE

**“VIZITAT SISTEMATIKE TË NXËNËSVE TË
SHKOLLAVE FILLORE TË MESME TË ULTA DHE
SHKOLLAVE TË MESME TË LARTA
TË KOMUNËS SË VUSHTRRIË”**

Periudha e realizimit të vizitave sistematike :
15/04/2015 – 18/06/2015

Koordinator i projektit : Dr. SAFET IDRIZI

VUSHTRRI

Hyrje

Mjekësia Familjare paraqet gurthemelin e Kujdesit Parësor Shëndetësor (KPSH) dhe mbrojtjes shëndetësore dhe njëherit portën hyrëse përmes së cilës shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore shfrytëzojnë shërbimet e sistemit shëndetësor në Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe sipas nevojë referohen për shërbime shëndetësore të nivelit më të lartë.

Edhe pse koncepti i Mjekësisë Familjare parasheh ofrimin e shërbimeve shëndetësore edhe preventive edhe kurative për shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore të zonave të përgjegjësisë të cilat i mbulojnë Qendrat e Mjekësisë Familjare, prapë se prapë për shkak të mosekzistimit të një mekanizmi i cili do t'i obligonte shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore në baza të rregullta kohore të vizitohen në Qendrat e Mjekësisë Familjare me qëllim të përcjelljes së gjendjes shëndetësore dhe detektimit të hershëm si dhe parandalimit të patologjive të ndryshme, një pjesë e madhe e shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore, në këtë rast edhe e nxënësve, nuk i nënshtrohen vizitave mjekësore me kohë dhe lëshojnë mundësinë e detektimit të hershëm të patologjive eventuale.

Prandaj në kuadër të implementimit të konceptit të Mjekësisë Familjare, Drejtoria Komonale për Shëndetësi realizoi projektin e vizitave sistematike të nxënësve të SHFMU , SHML dhe fëmijëve parashkollor që ka të bëjë me vlerësimin e gjendjes shëndetësore të tyre dhe identifikimin e nxënësve gjatë këtyre vizitave të cilët do të referohen për kujdes të mëtejshëm shëndetësor. Ky projekt si ide është shtruar në vitin 2013, ndërsa planifikimi i projektit është bërë në vitin 2014.

Prapavija

Fëmijët e moshës shkollare dhe adoleshentët janë kategori e veçantë për shkak të rritjes dhe zhvillimit aktiv karakteristik për moshën, prandaj si kategori e veçantë që janë kërkojnë edhe kujdes të veçantë shëndetësor. Madje shëndeti i fëmijëve dhe adoleshentëve është tregues i rëndësishëm i gjendjes shëndetësore të popullatës në përgjithësi.

Për shkak të mosekzistimit të mjekëve nëpër shkolla përkatësisht, mjekësisë shkollare e cila do të mundësonte përcjelljen e zhvillimit dhe rritjes së nxënësve dhe rrjedhimisht do të detektonte në fazat e hershme patologjitë të cilat do të mund të parandaloheshin, organizimi i vizitave sistematike të nxënësve paraqet një ndërmarrje të domosdoshme dhe të dobishme e cila deri diku e plotëson këtë vakuum, deri në zbatimin e plotë të konceptit të mjekësisë familjare kur do të mundësohet tërësisht zbatimi i komponentës parandaluese të kujdesit shëndetësor së bashku me kujdesin e vazhdueshëm biografik.

Funksionalizimi i komponentës parandaluese edhe ofruesit edhe shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore do t'i obligon për vizita dhe ekzaminime të rregullta shëndetësore, shërbime këto të cilat do të detektonin fillimin e devijimeve në fazat e hershme dhe ndërmarrjen e masave parandaluese dhe korrektuese. Parandalimi i sëmundjeve ka kosto më të lirë për sistemin dhe shërbimet shëndetësore se sa mjekimi i tyre, prandaj edhe ky fakt e rritë rëndësinë dhe peshën e vizitave sistematike.

Rëndësia e vizitave sistematike të nxënësve (skriningut)

Kujdesi për shëndetin e fëmijëve dhe adoleshentëve, përkatësisht kujdesi për rritjen dhe zhvillimin psikofizik të tyre paraqet njërin prej prioriteteve kryesore të politikave shëndetësore të shumicës së vendeve Evropiane. Poashtu si prioritet kryesor, shëndetin e fëmijëve dhe adoleshentëve e ka vënë edhe OBSH, respektivisht Komiteti Regjional për Evropë në sesionin e 53-të të vitit 2003.

Përcjellja e rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve dhe adoleshentëve përmes vizitave sistematike (skriningut) nëpër shkolla mundëson zbulimin e nxënësve me çrregullime apo defekte fizike dhe mendore të cilat e pamundësojnë zhvillimin e drejtë të tyre. Këto vizita rrjedhimisht kontribuojnë në dizajnimin e politikave shëndetësore të cilat orientohen kah zgjidhja e problemeve të identifikuara.



Pamje nga vizita e Kryetarit të Komunës z.Bajram Mulaku, Drejtorit të DSHMS-së dhe Drejtoreshës së QKMF-së gjatë vizitave sistematike të nxënësve.

Aq më tepër realizimi i një projekti të këtillë është më se i rëndësishëm kur kemi parasysh faktin se prej pas luftës d.m.th për më tepër se 14 vite nuk janë kryer vizita sistematike nëpër shkollat e Komunës së Vushtrisë dhe nuk disponojmë me një pasqyrë të përgjithshme me të dhëna për zhvillimin fizik dhe psikik të nxënësve.

Të dhënat e fituara nga këto vizita sistematike do të krijojnë një pasqyrë të përgjithshme për gjendjen shëndetësore të nxënësve, do të identifikojnë problemet më të shpeshta shëndetësore apo ngecjet në zhvillimin dhe përparimin fizik dhe psikik të nxënësve si dhe do të krijojnë një bazë të të dhënave e cila do të lehtëson dhe do të mbështesë dizajnimin e politikave shëndetësore por edhe ndërmarrjen e masave për përmirësimin e gjendjes shëndetësore të nxënësve.

Qëllimet e vizitave sistematike

1. Vlerësimi i nivelit të rritjes dhe zhvillimit psikofizik të fëmijëve të grupmoshave të caktuara, përkatësisht nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme prej klasëve të para (I) deri te klasët e dymbëdhjeta (XII) si dhe të fëmijëve parashkollor të Komunës së Vushtrrisë
2. Njohja dhe identifikimi i veçorive specifike të problemeve shëndetësore në grupmoshat e caktuara, që do mundëson zbulimin e hershëm të sëmundjeve dhe anomalive / çrregullimeve eventuale te fëmijët.
3. Dizajnimi dhe organizimi i intervenimeve me natyrë preventive, të bazuara në shkolla dhe komunitet.
4. Krijimi i një baze të të dhënave nga rezultatet e vizitave të realizuara e cila do të mbështesë modifikimin dhe përpilimin e politikave shëndetësore më favorizuese dhe përfituese për fëmijët dhe adoleshentët.

Parametrat e vlerësuar :

- Është vlerësuar zhvillimi i përgjithshëm psikofizik (**16 parametra**) • Shëndeti oral (**10 parametra**)

4

Kronologjia e aktiviteteve

Planifikimi i realizimit të vizitave sistematike

Me qëllim të përcaktimit të planit të punës dhe zbrërthimit të planit të punës në aktivitete, së pari është formuar grupi punues, në përbërje të koordinatorit, ndihmës koordinatorit, përgjegjësit për logjistikë, asistentit financiar, **Drejtorit të QKMF-së**, përgjegjësit të sektorit të Mjekësisë Familjare, përgjegjësit të sektorit të Shëndetit Oral, dhe kryeinfermieres të QKMF-së.

Poashtu, planifikimi është bërë edhe në bashkëpunim të ngushtë me **DKSH-së** dhe **Drejtorinë Komunale për Arsim** si dhe drejtoritë e Shkollave Fillore, nga të cilët paraprakisht është kërkuar pëlqimi për realizimin e vizitave. **Planifikimi i planit të punës dhe orarit të aktiviteteve është përpiluar në bazë të numrit të nxënësve dhe orarit mësimor të vitit shkollor paraprak, përkatësisht vitit shkollor 2013/2014. Nga të dhënat e grumbulluara nga përkrahësi për logjistikë i projektit, nëpër SHFMU dhe SHML, numri i përafërt i nxënësve në këtë vit shkollor ka rezultuar të jetë përafërsisht 14.891 nxënës, e që ka shërbyer si bazë për planifikimin e tërë projektit.**

Janë zhvilluar gjithashtu disa takime konsultative nga grupi punues, si dhe 1 takim për evaluim të projektit.



Pamje para fillimit të vizitës në Shkollën Fillore "Migjeni"

Para fillimit të realizimit të vizitave sistematike është mbajtur edhe një takim i veçantë i grupit punues ku u aprovua plani i punës për realizimin e vizitave sistematike në të gjitha SHFMU dhe SHML.

Sigurimi i materialit dhe mjeteve të punës

Bazuar në nevojat specifike për ekzaminimin e nxënësve nga Mjeku Familjar, Stomatologu, ekipi punues ka hartuar planin e nevojave dhe furnizimit me pajisje mjekësore, material stomatologjik dhe administrativ si dhe mjete harxhuese. Sigurimi i pajisjeve dhe materialit është bërë me kohë, sipas planit të paraparë dhe është deponuar para fillimit të vizitave sistematike.

Përgatitja e ekipeve mjekësore

Para daljes së ekipeve mjekësore nëpër shkolla për realizimin e vizitave mjekësore, është organizuar një takim konsultativ njëditor për personelin e ekipeve mjekësore lidhur me harmonizimin e metodologjisë dhe procedurave vlerësuese për të gjithë anëtarët e ekipeve punuese.

Realizimi i vizitave sistematike


Vizitat sistematike të nxënësve kanë filluar me **15/04/2015** dhe kanë përfunduar me **18/06/2015**. Vizitat janë realizuar sipas planit të përgatitur paraprakisht nga grupi punues, është ndjekur skema e rrjedhës së nxënësit e përgatitur posaçërisht për vizita sistematike, ndërsa të gjitha të dhënat/rezultatet e konstatuara nga vizita janë evidentuar në formularin e nxënësit.



Pamje nga puna e mjekut në SHML” Eqrem Çabej”

Përpunimi i formularëve të vizitave

Formularët e nxënësve janë përpunuar gjatë gjithë kohës sa kanë zgjatur vizitat sistematike nëpër shkolla, nga 3 operatorë të Sistemit Informator Shëndetësor. Formularët e përpunuar pastaj janë sistemuar sipas klasëve dhe shkollave dhe janë arkivuar në arkivën e QKMF-së. Përveç kopjes së fortë ruhet edhe kopja elektronike në SISH të QKMF-së.



Pamje nga përpunimi i formularëve me të dhëna nga vizitat e nxënësve
Tetor 2015

Mbikëqyrja dhe kontrolli i projektit

Mbikëqyrja e projektit është realizuar në baza të rregullta ditore nga koordinatori. Gjatë mbikëqyrjes është synuar minimizimi i mangësive, defekteve dhe minimizimi i devijimeve nga planifikimi.

Evalumi i projektit

Pas përfundimit të përpunimit të të dhënave, nga grupi punues i projektit është mbajtur takimi përfundimtar për diskutimin e rezultateve të vizitave sistematike, nxjerrjen e rekomandimeve dhe përpilimin e raportit përfundimtar i cili njëkohësisht shënon edhe përmbylljen e projektit.



Pamje nga takimi i grupit punues i cili bëri evaluimin e projektit

Buxheti i projektit

Ky projekt është financuar nga të Drejtoria Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Komunës së Vushtrrisë dhe kostoja financiare e këtij projekti është **8.828.88 €** . (Shiko raportin financiar të bashkangjitur si shtojcë).

Të dhënat e përgjithshme statistikore

- Numri i përgjithshëm i nxënësve të evidentuar: **14.891** (gjithashtu janë vizituar edhe **311** fëmijë parashkollor)
- Vizita të realizuara **12.613 (84.70 %)** - (tabela nr. 1)
- Numri i përgjithshëm i shkollave ku janë kryer vizitat sistematike : **48**, prej të cilave
 - 3 Shkolla të Mesme të Larta (SHML) dhe
 - **45** Shkolla Fillore të Mesme të Ulta (SHFMU), duke llogaritur këtu edhe paralelet e ndara të shkollave amë.
- Numri i ditëve të punës : **42 ditë pune**
- Numri i personelit të përfshirë në vizita : **26** (prej të cilëve **7** Mjekë Familjarë, **2** Doktorë të Stomatologjisë, **8** Infermiere familjare, **3** Asistente të Stomatologut, **2** operatorë për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave nga formularët, **1** koordinator të ekipeve punuese në terren, **1** furnizues për ekipet e terrenit.
- Ekipet punuese në terren – **4** ekipe; Që të 4 ekipet kanë punuar njëkohësisht në terren, në shkolla të ndryshme.
- Përbërja e ekipit punues : **1** Koordinator i ekipit
 - 1** Mjek Familjar
 - 1** Infermiere e mjekësisë Familjare
 - 1** Doktor i stomatologjisë
 - 1** Asistente e Doktorit të Stomatologjisë.
- Stafi koordinues i projektit : **1** Koordinator, **1** përgjegjës i logjistikës, (përgjegjësi i logjistikës është angazhuar edhe si koordinatorë i ekipeve punuese në terren).




Aspekte nga vizitat sistematike të nxënësve

Raport pune : “Vizitat sistematike të nxënësve të Shkollave Fillore të Mesme të Ulëta dhe Shkollave të Mesme të Larta të Komunës së Vushtrrisë - 2015”

Pasqyra e përfshirjes së nxënësve në vizitat sistematike						
Shkollat Fillore të Mesme të Ulta (SHFMU)						
SHFMU	Nxënës të planifikuar për vizita sistematike		Munguan		Vizita të realizuara	
	Nr. i nxënësve	%	Nr. i nxënësve	%	Nr. i nxënësve	%
Klasat I	1150	100.0	117	10.17	1033	89.83
Klasat II	1133	100.0	101	8.91	1032	91.09
Klasat III	1205	100.0	145	12.03	1060	87.97
Klasat IV	1228	100.0	33	2.69	1195	97.31
Klasat V	1188	100.0	80	6.73	1108	93.27
Klasat VI	1279	100.0	95	7.43	1184	92.57
Klasat VII	1373	100.0	159	11.58	1214	88.42
Klasat VIII	1528	100.0	117	7.66	1411	92.34
Klasat IX	1469	100.0	498	33.90	971	66.10
1. Gjithësejtë	11553	100.0	1345	11.64	10208	88.4
Shkollat e Mesme të Larta (SHML)						
SHML	Nxënës të planifikuar për vizita sistematike		Munguan		Vizita të realizuara	
	Nr. i nxënësve	%	Nr. i nxënësve	%	Nr. i nxënësve	%
Klasat X	1052	100.0	268	25.48	784	74.52
Klasat XI	1212	100.0	327	26.98	885	73.02
Klasat XII	1074	100.0	338	31.47	736	68.53
2. Gjithësejtë	3338	100.0	933	27.95	2405	72.05
Pasqyra e përgjithshme e realizimit të vizitave sistematike në SHFMU dhe SHML						
	Nxënës të planifikuar për vizita sistematike		Munguan		Vizita të realizuara	
	Nr. i nxënësve	%	Nr. i nxënësve	%	Nr. i nxënësve	%
SHFMU	11553	100.0	1345	11.64	10208	88.4
SHML	3338	100.0	933	27.95	2405	72.05
Totali 1+2	14891	100.0	2278	15.30	12613	84.70

Tabela nr. 1 – Pasqyrë e përfshirjes së nxënësve në vizita sistematike

Nga gjithësejtë **14.891** nxënës të planifikuar për vizita, janë vizituar **12613** apo **84.70 %**. Shkalla e realizimit të vizitave sipas klasave është paraqitur në *tabelën nr. 1*. Ndërsa në mënyrë grafike, rezultati i përgjithshëm i realizimit të vizitave paraqitet në *grafikonin nr. 1*.




Grafikoni nr. 1 – Shkalla e realizimit të vizitave sistematike në nivel komune.

Raporti gjinor i nxënësve të vizituar :

Raporti gjinor ndërmjet nxënësve të përfshirë në vizita						
Shkollat Fillore të Mesme të Ulta (SHFMU)						
SHFMU	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		Mëshkuj		Femra	
	Nr. i nxënësve	%	Nr. i nxënësve	%	Nr. i nxënësve	%
Klasat I	1033	100.0	536	51.9	497	48.1
Klasat II	1032	100.0	534	51.7	498	48.2
Klasat III	1060	100.0	556	52.5	504	47.5
Klasat IV	1195	100.0	630	52.7	565	47.3
Klasat V	1108	100.0	540	48.7	557	50.3
Klasat VI	1184	100.0	591	49.9	593	50.1
Klasat VII	1214	100.0	596	49.1	618	50.9
Klasat VIII	1411	100.0	715	50.7	696	49.3
Klasat IX	971	100.0	494	50.9	488	49.1
1. Gjithësejtë	10208	100.0	5192	50.9	5016	49.1
Shkollat e Mesme të Larta (SHML)						
SHML	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		Mëshkuj		Femra	
	Nr. i nxënësve	%	Nr. i nxënësve	%	Nr. i nxënësve	%
Klasat X	784	100.0	415	52.9	369	47.1
Klasat XI	885	100.0	412	46.6	473	53.4
Klasat XII	736	100.0	331	45.0	405	55.0
Klasat XIII						
2. Gjithësejtë	2405	100.0	1158	48.1	1247	51.9
Pasqyra e përgjithshme e raportit gjinor të nxënësëve të përfshirë në vizitave sistematike në SHFMU dhe SHML						
	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		Mashkuj		Femra	
	Nr. i nxënësve	%	Nr. i nxënësve	%	Nr. i nxënësve	%
SHFMU	10208	100.0	5192	50.9	5016	49.1
SHML	2405	100.0	1158	48.1	1247	51.9
Totali 1+2	12613	100.0	6350	50.3	6263	49.7

Tabela nr. 2 – Raporti gjinor i nxënësve të vizituar

Janë vizituar gjithësejt **6350 djem (50.3 %)** dhe **vajza 6263 (49.7%)**. Struktura gjinore e nxënësve të vizituar, paraqitet në *tabelën nr.2* dhe *grafikonin nr. 2*



Grafikoni nr. 2 – Struktura gjinore e nxënësve të SHFMU dhe SHML

REZULTATET


1. Lartësia (gjatësia)

Lartësia(gjatësia) e nxënësve të SHFMU dhe SHML (sipas viteve)									
Vitet		Nr.	%	Vitet		Nr.		%	
						M	F	M	F
6	L. Ulët për moshë	100	9.1%	12	L. Ulët për moshë	47	77	9.2%	14.6%
	Normal	876	79.9%		Normal	417	346	81.6%	65.5%
	L. lartë për moshë	120	10.9%		L. lartë për moshë	66	146	12.9%	27.7%
7	L. ulët për moshë	67	7.8%	13	L. Ulët për moshë	42	71	6.7%	11.7%
	Normal	691	80.2%		Normal	545	502	86.6%	83.0%
	L.lartë për moshë	104	12.1%		L. lartë për moshë	62	64	9.9%	10.6%
8	L.Ulët për moshë	71	7.3%	14	L. Ulët për moshë	85	94	13.4%	13.5%
	Normal	815	83.6%		Normal	536	539	84.5%	77.7%
	L. lartë për moshë	89	9.1%		L. lartë për moshë	13	61	2.1%	8.8%
9	L. Ulët për moshë	81	7.7%	15	L. Ulët për Moshë	39	48	7.4%	8.7%
	Normal	904	86.2%		Normal	440	474	83.3%	85.6%
	L. lartë për moshë	64	6.1%		L. lartë për moshë	49	32	9.3%	5.8%
10	L. Ulët për moshë	97	8.5%	16	L. Ulët për moshë	26	23	6.1%	6.2%
	Normal	921	80.4%		Normal	372	321	87.1%	86.8%
	L. lartë për moshë	128	11.2%		L. lartë për moshë	29	26	6.8%	7.0%
11	L. Ulët për moshë	84	7.8%	17	L. Ulët për moshë	29	28	7.3%	6.2%
	Normal	855	79.8%		Normal	338	383	85.4%	84.5%
	L. lartë për moshë	133	12.4%		L. lartë për moshë	29	42	7.3%	9.3%
				18	L. Ulët për moshë	10	24	3.6%	6.3%
					Normal	233	329	84.1%	86.8%
					L. lartë për moshë	34	26	12.3%	6.9%
			19	L. Ulët për moshë	4	14	2.8%	14.4%	
				Normal	134	76	94.4%	78.4%	
				L. lartë për moshë	4	7	2.8%	7.2%	


Tabela nr. 3 – Lartësia trupore e nxënësve të SHFMU dhe SHML

Rezultatet e fituara nga matja e lartësisë trupore e nxënësve të SHFMU dhe SHML tregojnë se në total **81.7 %** e nxënësve kanë lartësi normale, ndërsa vetëm **8 %** janë me lartësi të ultë për moshë dhe **10.3%** lartësi trupore të lartë për moshë(grupmosha për vitet **6,7,8,9,10,11**),ndërsa për grupmoshat e viteve (**12,13,14,15,16,17,18**)në total **85.9%**e nxënësve të gjinisë mashkullore kanë lartësi normale, **7.1%** kanë lartësi të ulët për moshë dhe **7.9%** kanë lartësi të naltë për moshë, kurse të gjinia femërore për këtë grupmoshë në total **81.0%** janë me lartësi normale,**10.2%** me lartësi të ulët për moshë dhe **10.4%** me lartësi të lartë për moshë. Interpretimi i rezultateve është bërë duke u bazuar në referencat e Organizatës Botërore për Shëndetësi (OBSh) të vitit 2007 për lartësi trupore. Të dhënat më të hollëishme sipas viteve janë prezantuar në *tabelën nr. 3* si dhe *grafikonin nr. 3*

Raport pune : “Vizitat sistematike të nxënësve të Shkollave Fillore të Mesme të Ulëta dhe Shkollave të Mesme të Larta të Komunës së Vushtrrisë - 2015”



Grafikoni nr. 3 – Lartësia trupore e nxënësve të SHFMU dhe SHML



Grafikoni nr3. – Lartësia trupore e nxënësve sipas viteve 12,13,14,15,16,17,18,19.

2. Lartësia mesatare sipas gjinisë dhe klasëve

Lartësia (gjatësia) mesatare e nxënësve		
Shkolla Fillore të Mesme të Ulta		
SHFMU	Lartësia mesatare (cm.)	
	Mashkuj	Femra
Klasar I	1.23	1.21
Klasar II	1.29	1.27
Klasar III	1.34	1.33
Klasar IV	1.39	1.38
Klasar V	1.45	1.45
Klasar VI	1.49	1.53
Klasar VII	1.58	1.57
Klasar VIII	1.64	1.61
Klasar IX	1.71	1.61
Shkollat e Mesme të Larta		
SHML	Lartësia mesatare (cm.)	
	Mashkuj	Femra
Klasat X	1.73	1.61
Klasat XI	1.76	1.63
Klasat XII	1.76	1.63

Tabela nr. 4 Lartësia mesatare e nxënësve të SHFMU dhe SHML

Nga rezultatet e fituara gjatë matjes së lartësisë trupore, janë llogaritur lartësitë trupore mesatare sipas gjinisë dhe klasëve. Këto rezultate janë paraqitur në **tabelën nr. 4** dhe **grafikonin nr. 4**





Figura nr. 4 – Lartësia trupore mesatare e nxënësve të SHFMU dhe SHML sipas gjinisë dhe klasëve

3. Pesha trupore

Nga rezultatet e matjeve të peshës së nxënësve është llogaritur pesha mesatare për meshkuj dhe femra, që paraqitet në mënyrë tabelare në *tabelën nr. 5* dhe grafike në *grafikonin nr. 5*.

Pesha mesatare e nxënësve		
Shkolla Fillore të Mesme të Ulëta		
SHFMU	Pesha mesatare (kg)	
	Meshkuj	Femra
Klasar I	22.9	22.2
Klasar II	28.1	24.9
Klasar III	29.8	28.5
Klasar IV	32.6	31.4
Klasar V	35.2	37.1
Klasar VI	40.3	41.7
Klasar VI	47.9	47.6
Klasar VII	54.1	52.2
Klasar IX	60.5	54.5
Shkollat e Mesme të Larta		
SHML	Pesha mesatare (kg)	
	Mashkuj	Femra
Klasat X	64.5	57.3
Klasat XI	66.4	57.3
Klasat XII	70.3	58.7

Tabela 5 – Pesha mesatare




Grafikoni nr. 5 – Pesha mesatare sipas klasëve dhe gjinisë

5. Statusi vaksinal

Statusi vaksinal i nxënësve të SHFMU dhe SHML								
Shkollat Fillore të Mesme të Ulëta (SHFMU)								
SHFMU	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		I kompletuar		Jo I kompletuar		Mungojnë të dhënat	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Klasat I	1033	100.0	1016	98.4	7	0.7	9	0.9
Klasat II	1032	100.0	1025	99.3	6	0.6	1	0.1
Klasat III	1060	100.0	1047	98.8	9	0.8	4	0.4
Klasat IV	1195	100.0	1184	99.1	8	0.7	3	0.3
Klasat V	1108	100.0	1101	99.4	5	0.5	2	0.2
Klasat VI	1184	100.0	1175	99.2	9	0.8	0	0
Klasat VII	1214	100.0	1212	99.8	0	0	2	0.2
Klasat VIII	1411	100.0	1409	99.9	0	0	2	0.1
Klasat IX	971	100.0	969	99.8	0	0	2	0.2
1. Gjithësejtë	10208	100.0	10138	99.3	44	0.4	25	0.2
Shkollat e Mesme të Larta (SHML)								
SHML	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		I kompletuar		Jo I kompletuar		Mungojnë të dhënat	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Klasat X	784	100.0	769	98.1	15	1.9	0	0
Klasat XI	885	100.0	884	99.9	1	0.1	0	0
Klasat XII	736	100.0	734	99.7	1	0.1	1	0.1
2. Gjithësejtë	2405	100.0	2387	99.3	17	0.7	1	0.04
Pasqyrë e përgjithshme e statusit vaksinal të nxënësve të SHFMU dhe SHML								
	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		I kompletuar		Jo I kompletuar		Mungojnë të dhënat	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
SHFMU	10208	100.0	10138	99.3	44	0.4	25	0.2
SHML	2405	100.0	2387	99.3	17	0.7	1	0.04
Totali = 1+2	12613	100.0	12525	99.3	61	0.5	26	0.2

Tabela 6 – Pasqyrë e statusit vaksinal

Nga të dhënat e fituara nga deklaratimet e nxënësve, është nxjerrur pasqyra e statusit vaksinal të nxënësve, për vaksinat e obliguara sipas kalendarit të vaksinimit. Këto të dhëna janë paraqitur sipas klasëve në *tabelën nr. 6* dhe *grafikonin nr. 6*. Sipas deklaratimit të nxënësve, **99.3%** prej tyre e kanë kompletuar statusin vaksinal.




Grafikoni nr. 6 – Pasqyrë e statusit vaksinal të nxënësve

6. Koka dhe qafa

Koka dhe Qafa								
Shkollat Fillore të Mesme të Ulta (SHFMU)								
SHFMU	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		PVP		MVP		Mungojnë të dhënat	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Klasat I	1033	100.0	1033	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Klasat II	1032	100.0	1028	99.6	0.0	0.0	3	0.3
Klasat III	1060	100.0	1060	100	0.0	0.0	0.0	0.0
Klasat IV	1195	100.0	1195	100	0.0	0.0	0.0	0.0
Klasat V	1108	100.0	1101	99.4	6	0.5	0.0	0.0
Klasat VI	1184	100.0	1174	99.2	4	0.3	5	0.4
Klasat VII	1214	100.0	1205	99.3	4	0.3	5	0.4
Klasat VIII	1411	100.0	1397	99.0	10	0.7	3	0.3
Klasat IX	971	100.0	968	99.7	2	0.2	1	0.1
1. Gjithësejtë	10208	100.0	10161	99.5	28	0.3	17	0.2
Shkollat e Mesme të Larta (SHML)								
SHML	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		PVP		MVP		Mungojnë të dhënat	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Klasat X	784	100.0	770	98.2	10	1.3	4	0.5
Klasat XI	885	100.0	868	98.1	13	1.5	5	0.6
Klasat XII	736	100.0	717	97.4	18	2.4	1	0.1
2. Gjithësejtë	2405	100.0	2355	97.9	41	1.7	10	0.4
Koka dhe qafa (Pasqyrë e përgjithshme SHFMU dhe SHML)								
	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		PVP		MVP		Mungojnë të dhënat	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
SHFMU	10208	100.0	10161	99.5	28	0.3	17	0.2
SHML	2405	100.0	2355	97.9	41	1.7	10	0.4
Totali = 1+2	12613	100.0	12516	99.3	69	0.5	27	0.2

Tabela nr. 7 - Paraqitja tabelare e rezultateve të vlerësimit për kokë dhe qafë

Vlera e përgjithshme, për të gjithë nxënësit e SHFMU dhe SHML, me veçorive patologjike është **vetëm 0.5%**, përkatësisht 99.3% e vlerësimeve janë pa veçori patologjike. Rezultatet e fituara nga vizitat sipas klasëve janë të paraqitura në **tabelën nr.7**, ndërsa ato të përgjithshme në **grafikonin nr.7**.




Grafikoni nr. 7 – Paraqitja grafike e rezultateve të vlerësimit të gjendjes së kokës dhe qafës

7. Kafazi i kraheorrit

Kafazi i kraheorrit								
Shkollat Fillore të Mesme të Ulta (SHFMU)								
SHFMU	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		PVP		MVP		Mungojnë të dhënat	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Klasat I	1033	100.0	1028	99.5	5		0.0	0.0
Klasat II	1032	100.0	1014	98.3	14	1.4	4	0.4
Klasat III	1060	100.0	1040	98.1	20	1.9	0.0	0.0
Klasat IV	1195	100.0	1180	98.7	15	1.3	0.0	0.0
Klasat V	1108	100.0	1093	98.6	10	0.9	5	0.5
Klasat VI	1184	100.0	1130	95.4	19	1.6	35	3.0
Klasat VII	1214	100.0	1196	98.5	13	1.1	5	0.4
Klasat VIII	1411	100.0	1381	97.9	28	2.0	2	0.1
Klasat IX	971	100.0	943	97.1	27	2.8	1	0.1
1. Gjithësejtë	10208	100.0	10005	98.0	151	1.5	52	0.5
Shkollat e Mesme të Larta (SHML)								
SHML	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		PVP		MVP		Mungojnë të dhënat	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Klasat X	784	100.0	772	95.5	9	1.1	3	0.4
Klasat XI	885	100.0	875	98.9	7	0.8	3	0.3
Klasat XII	736	100.0	718	97.6	16	2.2	2	0.3
2. Gjithësejtë	2405	100.0	2365	98.3	32	1.3	8	0.3
Kafazi i kraheorrit (Pasqyrë e përgjithshme SHFMU dhe SHML)								
	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		PVP		MVP		Mungojnë të dhënat	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
SHFMU	10208	100.0	10005	98.0	151	1.5	52	0.5
SHML	2405	100.0	2365	98.3	32	1.3	8	0.3
Totali = 1+2	12613	100.0	12370	98.1	183	1.5	60	0.48

Tabela nr. 8 – Paraqitja tabelare e rezultateve të vlerësimit të gjendjes së kafazit të kraheorrit

Vlera e përgjithshme, për të gjithë nxënësit e SHFMU dhe SHML, me veçori patologjike të kafazit të kraheorrit është vetëm **1.5%**, përkatësisht **98.1%** e e vlerësimeve janë pa veçori patologjike. Rezultatet e fituara nga vizitat sipas klasëve janë të paraqitura në **tabelën nr. 8**, ndërsa ato të përgjithshme në **grafikonin nr.8**.




Grafikoni nr. 8 – Paraqitja grafike e rezultateve të vlerësimit të gjendjes së kafazit të kraheorrit

8. Boshti kurrizor

Boshti kurrizor												
Shkollat Fillore të Mesme të Ulta (SHFMU)												
SHFMU	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		PVP		Skoliozë		Kifozë		Lordozë		Mungojnë të dhënat	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Klasat I	1033	100.0	1032	99.9	0	0.0	1	0.1	0	0.0	0	0.0
Klasat II	1032	100.0	1016	98.4	7	0.7	4	0.4	0	0.0	5	0.5
Klasat III	1060	100.0	1051	99.2	9	0.8	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Klasat IV	1195	100.0	1184	99.1	9	0.8	3	0.3	0	0.0	0	0.0
Klasat V	1108	100.0	1084	97.8	9	0.8	9	0.8	2	0.2	0	0.0
Klasat VI	1184	100.0	1151	97.2	18	1.5	8	0.7	1	0.1	5	0.4
Klasat VII	1214	100.0	1157	95.3	36	3.0	16	1.3	2	0.2	2	0.2
Klasat VIII	1411	100.0	1345	95.3	47	3.3	18	1.3	0	0.0	2	0.1
Klasat IX	971	100.0	921	94.9	31	3.2	17	1.8	0	0.0	5	0.6
1. Gjithësejtë	10208	100.0	9941	97.4	166	1.6	76	0.7	5	0.05	19	0.2
Shkollat e Mesme të Larta (SHML)												
SHML	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		PVP		Skoliozë		Kifozë		Lordozë		Mungojnë të dhënat	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Klasat X	784	100.0	750	95.7	14	1.8	13	1.7	2	0.3	5	0.6
Klasat XI	885	100.0	826	93.3	26	2.9	31	3.5	0	0.0	3	0.3
Klasat XII	736	100.0	689	93.6	16	2.2	26	3.4	1	0.1	1	0.1
2. Gjithësejtë	2405	100.0	2265	94.2	56	2.3	71	3.0	3	0.1	9	0.4
Boshti kurrizor (Pasqyrë e përgjithshme SHFMU dhe SHML)												
	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		PVP		Skoliozë		Kifozë		Lordozë		Mungojnë të dhënat	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
SHFMU	10208	100.0	9941	97.4	166	1.6	76	0.7	5	0.05	19	0.2
SHML	2405	100.0	2265	94.2	56	2.3	71	3.0	3	0.1	9	0.4
Totali = 1+2	12613	100.0	12.206	96.8	222	1.8	147	1.2	8	0.1	28	0.2

Tabela nr. 9 – Paraqitja tabelare e rezultateve të vlerësimit të gjendjes së boshtit kurrizor

Nga gjithësejtë **12613** nxënës të SHFMU dhe SHML, në **96.8%** prej tyre nuk janë konstatuar veçori patologjike të boshtit kurrizor, ndërsa te **1.8%** prej tyre është konstatuar **skolioza**, te **1.2%** prej tyre **kifoza** dhe **0.1%** prej tyre **lordoza**. Rezultatet e hulumtimit sipas klasëve janë paraqitur në *tabelën nr. 9*, derisa pasqyra e përgjithshme është paraqitur në *grafikonin nr. 9*.




Grafikoni nr. 9 – Paraqitja grafike e rezultateve të vlerësimit të gjendjes së kafazit të boshtit kurrizor

9. Qëndrimi i trupit

Qëndrimi i Trupit								
Shkollat Fillore të Mesme të Ulta (SHFMU)								
SHFMU	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		PVP		MVP		Mungojnë të dhënat	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Klasat I	1033	100.0	1029	99.6	4	0.4	0.0	0.0
Klasat II	1032	100.0	1008	97.7	19	1.8	5	0.5
Klasat III	1060	100.0	1048	98.9	12	1.1	0.0	0.0
Klasat IV	1195	100.0	1174	98.2	20	1.7	1	0.1
Klasat V	1108	100.0	1073	96.8	30	2.7	5	0.5
Klasat VI	1184	100.0	1132	95.6	43	3.6	9	0.8
Klasat VII	1214	100.0	1145	94.3	59	4.9	8	0.7
Klasat VIII	1411	100.0	1313	93.1	95	6.7	3	0.2
Klasat IX	971	100.0	883	90.9	87	9.0	1	0.1
1. Gjithësejtë	10208	100.0	9805	96.1	369	3.6	32	0.3
Shkollat e Mesme të Larta (SHML)								
SHML	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		PVP		MVP		Mungojnë të dhënat	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Klasat X	784	100.0	752	95.9	29	3.7	3	0.4
Klasat XI	885	100.0	847	95.7	35	4.0	3	0.3
Klasat XII	736	100.0	691	93.9	45	6.1	0	0.0
2. Gjithësejtë	2405	100.0	2290	95.2	109	4.5	6	0.2
Qenrimi i trupit (Pasqyrë e përgjithshme SHFMU dhe SHML)								
	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		PVP		MVP		Mungojnë të dhënat	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
SHFMU	10208	100.0	9805	96.1	369	3.6	32	0.3
SHML	2405	100.0	2290	95.2	109	4.5	6	0.2
Totali = 1+2	12613	100.0	12095	95.9	478	3.8	38	0.3

Tabela nr. 10 – Paraqitja tabelare e rezultateve të vlerësimit të qëndrimit të trupit

Nga vlerësimi i qëndrimit të trupit, vetëm te **3.8%** prej tyre është konstatuar **qëndrim jo i drejtë**, ndërsa te 95.9% është konstatuar se kanë qëndrim të drejtë. Pasqyra e përgjithshme për të gjitha klasët si dhe dallimi ndërmjet tyre mund të shihen në *tabelën nr. 10*, ndërsa paraqitja grafike në *grafikonin nr. 10*.




Grafikoni nr. 10 – Paraqitja grafike e rezultateve të vlerësimit të qëndrimit të trupit

10. Mushkëritë

Mushkëritë								
Shkollat Fillore të Mesme të Ulëta (SHFMU)								
SHFMU	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		PVP		MVP		Mungojnë të dhënat	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Klasat I	1033	100.0	1029	99.6	4	0.4	0.0	0.0
Klasat II	1032	100.0	1026	99.4	3	0.3	3	0.3
Klasat III	1060	100.0	1036	97.7	6	0.6	18	1.7
Klasat IV	1195	100.0	1192	99.7	1	0.1	2	0.2
Klasat V	1108	100.0	1080	97.5	6	0.5	22	2.0
Klasat VI	1184	100.0	1174	99.2	0	0.0	10	0.8
Klasat VII	1214	100.0	1189	97.9	4	0.3	21	1.7
Klasat VIII	1411	100.0	1405	99.6	3	0.2	3	0.2
Klasat IX	971	100.0	959	98.8	1	0.1	11	0.1
1. Gjithësejtë	10208	100.0	10090	98.8	28	0.3	90	0.9
Shkollat e Mesme të Larta (SHML)								
SHML	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		PVP		MVP		Mungojnë të dhënat	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Klasat X	784	100.0	774	98.7	2	0.3	8	1.0
Klasat XI	885	100.0	880	99.4	2	0.2	3	0.3
Klasat XII	736	100.0	729	99.0	2	0.3	5	0.7
2. Gjithësejtë	2405	100.0	2383	99.1	6	0.2	16	0.7
Mushkëritë (Pasqyrë e përgjithshme SHFMU dhe SHML)								
	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		PVP		MVP		Mungojnë të dhënat	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
SHFMU	10208	100.0	10090	98.8	28	0.3	90	0.9
SHML	2405	100.0	2383	99.1	6	0.2	16	0.7
Totali = 1+2	12613	100.0	12473	98.9	34	0.3	106	0.8

Tabela nr. 11 – Paraqitja tabelare e rezultateve të vlerësimit të mushkërive
 Nga vlerësimi i mushkërive, vetëm te një përqindje e vogël, simbolike, prej **0.3%** e nxënësve janë vlerësuar **me veçori patologjike**, ndërsa 98.9% janë vlerësuar PVP. Pasqyra e përgjithshme për të gjitha klasët si dhe dallimi ndërmjet tyre mund të shihen në **tabelën nr. 11**, ndërsa paraqitja grafike në **grafikoni nr. 11**.




Grafikoni nr. 11 – Paraqitja grafike e rezultateve të vlerësimit të mushkërive ...

11. Zemra

Zemra								
Shkollat Fillore të Mesme të Ulëta (SHFMU)								
SHFMU	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		PVP		MVP		Mungojnë të dhënat	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Klasat I	1033	100.0	1032	99.9	1	0.1	0.0	0.0
Klasat II	1032	100.0	1027	99.5	3	0.3	2	0.2
Klasat III	1060	100.0	1057	99.7	3	0.3	0.0	0.0
Klasat IV	1195	100.0	1192	99.7	3	0.3	0.0	0.0
Klasat V	1108	100.0	1094	98.7	7	0.6	7	0.6
Klasat VI	1184	100.0	1172	99.0	1	0.1	11	0.9
Klasat VII	1214	100.0	1209	99.6	1	0.1	4	0.3
Klasat VIII	1411	100.0	1401	99.3	5	0.4	5	0.4
Klasat IX	971	100.0	966	99.5	3	0.3	2	0.2
1. Gjithësejtë	10208	100.0	10150	99.4	27	0.3	31	0.3
Shkollat e Mesme të Larta (SHML)								
SHML	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		PVP		MVP		Mungojnë të dhënat	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Klasat X	784	100.0	779	99.4	2	0.3	3	0.4
Klasat XI	885	100.0	875	98.9	9	1.0	1	0.1
Klasat XII	736	100.0	728	98.9	5	0.7	3	0.4
2. Gjithësejtë	2405	100.0	2382	99.0	16	0.7	7	0.3
Zemra (Pasqyrë e përgjithshme SHFMU dhe SHML)								
	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		PVP		MVP		Mungojnë të dhënat	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
SHFMU	10208	100.0	10150	99.4	27	0.3	31	0.3
SHML	2405	100.0	2382	99.0	16	0.7	7	0.3
Totali = 1+2	12613	100.0	12532	99.4	43	0.3	38	0.3

Tabela nr. 12 – Paraqitja tabelare e rezultateve të vlerësimit të zemrës

Nga gjithësejtë 12613 nxënës të SHFMU dhe SHML, në 99.4% prej tyre nuk janë konstatuar veçori patologjike të zemrës, ndërsa te vetëm **0.3%** prej tyre është është dyshuar për veçori patologjike. Rezultatet e vlerësimit sipas klasëve janë paraqitur në *tabelën nr. 12*, derisa pasqyra e përgjithshme është paraqitur në *grafikonin nr. 12*.




Grafikoni nr. 12 – Paraqitja grafike e rezultateve të vlerësimit të zemrës

12. Menarha

Menarha									
Shkollat Fillore të Mesme të Ulëta (SHFMU)									
SHFMU	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		PO		JO		Mungojnë të dhënat		
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
Klasat V	557	100.0	13	2.3	544	97.7	0	0.0	
Klasat VI	593	100.0	130	21.9	444	74.9	19	3.2	
Klasat VII	618	100.0	333	53.9	277	44.8	8	1.3	
Klasat VIII	696	100.0	555	79.7	134	19.3	7	1.0	
Klasat IX	488	100.0	438	89.8	24	4.9	26	5.3	
1. Gjithësejtë	2952	100.0	1469	49.8	1423	48.2	60	2.0	
Shkollat e Mesme të Larta (SHML)									
SHML	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		PO		JO		Mungojnë të dhënat		
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
Klasat X	369	100.0	360	97.6	8	2.2	1	0.3	
Klasat XI	473	100.0	464	98.1	9	1.9	0	0.0	
Klasat XII	405	100.0	393	97.0	9	2.2	3	0.7	
2. Gjithësejtë	1247	100.0	1217	97.6	26	2.1	4	0.3	
Menarha (Pasqyrë e përgjithshme SHFMU dhe SHML)									
	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		PO		JO		Mungojnë të dhënat		
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
SHFMU	2952	100.0	1469	49.8	1423	48.2	60	2.0	
SHML	1247	100.0	1217	97.6	26	2.1	4	0.3	
Totali = 1+2	4199	100.0	2686	64.0	1449	34.5	64	1.5	

Tabela nr. 13 – Prezantimi tabelar i paraqitjes së menarhës

Vlerësimi i paraqitjes së menarhës është bërë prej klasës së pestë(V) të SHFMU. Në *tabelën nr. 13* paraqiten rezultatet që tregojnë numrin apo përqindjen e vajzave të cilat është paraqitur menarha. Në mënyrë grafike këto të dhëna paraqiten në *grafikonin nr. 13*.




Grafikoni nr. 13 –Prezantimi grafik i paraqitjes së menarhës ...

13. Extremitetet

Extremitetet								
Shkollat Fillore të Mesme të Ulëta (SHFMU)								
SHFMU	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		PVP		MVP		Mungojnë të dhënat	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Klasat I	1033	100.0	1031	99.8	2	0.2	0	0.0
Klasat II	1032	100.0	1030	99.8	0	0.0	2	0.2
Klasat III	1060	100.0	1058	99.8	2	0.2	0	0.0
Klasat IV	1195	100.0	1189	99.5	3	0.3	3	0.3
Klasat V	1108	100.0	1101	99.4	2	0.2	5	0.5
Klasat VI	1184	100.0	1169	98.7	1	0.1	14	1.2
Klasat VII	1214	100.0	1203	99.1	8	0.7	4	0.3
Klasat VIII	1411	100.0	1402	99.4	5	0.4	3	0.2
Klasat IX	971	100.0	969	99.8	1	0.1	1	0.1
1. Gjithësejtë	10208	100.0	10152	99.5	24	0.2	32	0.3
Shkollat e Mesme të Larta (SHML)								
SHML	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		PVP		MVP		Mungojnë të dhënat	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Klasat X	784	100.0	774	98.7	5	0.6	5	0.6
Klasat XI	885	100.0	873	98.6	9	1.0	3	0.3
Klasat XII	736	100.0	735	99.9	0	0.0	1	0.1
2. Gjithësejtë	2405	100.0	2382	99.0	14	0.6	9	0.4
Extremitetet (Pasqyrë e përgjithshme SHFMU dhe SHML)								
	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		PVP		MVP		Mungojnë të dhënat	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
SHFMU	10208	100.0	10152	99.5	24	0.2	32	0.3
SHML	2405	100.0	2382	99.0	14	0.6	9	0.4
Totali = 1+2	12613	100.0	12534	99.4	38	0.3	41	0.3

Tabela nr. 14 – Prezantimi tabelar i vlerësimit të extremiteteve

Nga gjithësejtë 12613 nxënës të SHFMU dhe SHML, në 99.4% prej tyre nuk janë konstatuar veçori patologjike të ekstremiteteve, ndërsa te **0.3%** prej tyre janë konstatuar shputat e rrafshëta. Rezultatet e vlerësimit sipas klasëve janë paraqitur në *tabelën nr. 14*, derisa pasqyra e përgjithshme është paraqitur në *grafikonin nr. 14*.




Grafikoni nr. 14 – Prezantimi grafik i vlerësimit të extremiteteve
Tetor 2015

14. Të pamurit

Të pamurit									
Shkollat Fillore të Mesme të Ulëta (SHFMU)									
SHFMU	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		PVP		MVP		Mungojnë të dhënat		
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
Klasat I	1033	100.0	814	78.8	216	20.9	3	0.3	
Klasat II	1032	100.0	770	74.6	258	25.0	4	0.4	
Klasat III	1060	100.0	823	77.6	236	22.3	1	0.1	
Klasat IV	1195	100.0	924	77.3	268	22.4	3	0.3	
Klasat V	1108	100.0	864	78.0	239	21.6	5	0.5	
Klasat VI	1184	100.0	973	82.2	205	17.3	6	0.5	
Klasat VII	1214	100.0	948	78.1	264	21.7	2	0.2	
Klasat VIII	1411	100.0	1088	77.1	321	22.7	2	0.1	
Klasat IX	971	100.0	711	73.2	260	26.8	0	0.0	
1. Gjithësejtë	10208	100.0	7915	77.6	2267	22.2	26	0.3	
Shkollat e Mesme të Larta (SHML)									
SHML	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		PVP		MVP		Mungojnë të dhënat		
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
Klasat X	784	100.0	605	77.2	178	22.7	1	0.1	
Klasat XI	885	100.0	673	76.0	211	23.8	1	0.1	
Klasat XII	736	100.0	522	70.9	209	28.4	5	0.7	
2. Gjithësejtë	2405	100.0	1800	74.8	598	24.9	7	0.3	
Të pamurit (Pasqyrë e përgjithshme e SHFMU dhe SHML)									
	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		PVP		MVP		Mungojnë të dhënat		
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
SHFMU	10208	100.0	7915	77.6	2267	22.2	26	0.3	
SHML	2405	100.0	1800	74.8	598	24.9	7	0.3	
Totali = 1+2	12613	100.0	9715	77.0	2865	22.7	33	0.3	

Tabela nr. 15 – Prezantimi tabelar i vlerësimit të të pamurit

Nga numri i përgjithshëm i nxënësve të kontrolluar, me veçori pataologjike të të pamurit janë vlerësuar **22.7%**. Shkalla e veçorive pataologjike sipas klasëve është paraqitur në **tabelën 15**, ndërsa pasqyra e përgjithshme në **grafikonin 15**.




Grafikonin nr. 15 – Prezantimi grafik i vlerësimit të të pamurit

14.1. Të pamurit – Nxënësit me syza apo thjerrëza kontakti për koreksion të çrregullimeve refraktare

Të pamurit - Nxënësit të cilët bartin syze për koreksion të refraktionit						
SHFMU	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		Me syza		Pa Syza	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Klasat I	1033	100	24	2.3%	1009	97.7%
Klasat II	1032	100	47	4.6%	985	95.4%
Klasat III	1060	100	48	4.5%	1012	95.5%
Klasat IV	1195	100	44	3.7%	1151	96.3%
Klasat V	1108	100	52	4.7%	1056	95.3%
Klasat VI	1184	100	37	3.1%	1147	96.9%
Klasat VII	1214	100	44	3.6%	1170	96.4%
Klasat VIII	1411	100	55	3.9%	1356	96.1%
Klasat IX	971	100	38	3.9%	933	96.1%
1. Gjithësejtë	10208	100	389	3.8%	9819	96.2%
Të pamurit- Nxënësit të cilët bartin syze për koreksion të refraktionit						
SHML	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		Me syza		Pa Syza	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Klasat X	784	100	23	2.9%	761	97.1%
Klasat XI	885	100	25	2.8%	860	97.2%
Klasat XII	736	100	17	2.3%	719	97.7%
2. Gjithësejtë	2405	100	65	2.7%	2340	97.3%
Të pamurit- Nxënësit të cilët bartin syze për koreksion të refraktionit						
	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		Me syza		Pa Syza	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
SHFMU	10208	100	389	3.8%	9819	96.2%
SHML	2405	100	65	2.7%	2340	97.3%
Totali =1+2	12613	100	454	3.6%	12159	96.4%

Tabela nr. 16 – Prezantimi tabelar i të dhënave për nxënës të cilët bartin syza

Në **tabelën nr. 16** paraqitet pasqyra e nxënësve të cilët bartin syza apo thjerrëza kontakti për koreksionin e çrregullimeve të refraktionit. Mesatarja e përgjithshme e nxënësve me syza apo thjerrëza është **3.6%**. Kjo përqindje e nxënësve të cilat bartin syza nuk është përfshirë në shkallën e referimeve. Në formën grafike shkalla e nxënësve të cilët bartin syza, paraqitet në **grafikonin nr. 16**.




Grafikoni nr. 16 – Prezantimi grafik i shkallës së nxënësve me syza apo thjerrëza kontakti

15. Të dëgjuarit

Të dëgjuarit								
Shkollat Fillore të Mesme të Ulëta (SHFMU)								
SHFMU	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		PVP		MVP		Mungojnë të dhënat	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Klasat I	1033	100.0	1032	99.9	1	0.1	0	0.0
Klasat II	1032	100.0	1024	99.2	3	0.3	5	0.5
Klasat III	1060	100.0	1052	99.2	2	0.2	6	0.6
Klasat IV	1195	100.0	1185	99.2	4	0.3	6	0.5
Klasat V	1108	100.0	1091	98.5	8	0.7	9	0.8
Klasat VI	1184	100.0	1165	98.4	10	0.8	9	0.8
Klasat VII	1214	100.0	1195	98.4	13	1.1	6	0.5
Klasat VIII	1411	100.0	1390	98.5	15	1.1	6	0.4
Klasat IX	971	100.0	959	98.8	9	0.9	1	0.1
1. Gjithësejtë	10208	100.0	10093	98.9	65	0.6	48	0.5
Shkollat e Mesme të Larta (SHML)								
SHML	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		PVP		MVP		Mungojnë të dhënat	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Klasat X	784	100.0	766	97.7	10	1.3	8	1.0
Klasat XI	885	100.0	866	97.9	18	2.0	3	0.3
Klasat XII	736	100.0	717	97.4	18	2.4	1	0.1
2. Gjithësejtë	2405	100.0	2349	97.7	46	1.9	12	0.5
Të dëgjuarit (Pasqyrë e përgjithshme e SHFMU dhe SHML)								
	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		PVP		MVP		Mungojnë të dhënat	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
SHFMU	10208	100.0	10093	98.9	65	0.6	48	0.5
SHML	2405	100.0	2349	97.7	46	1.9	12	0.5
Totali = 1+2	12613	100.0	12442	98.6	111	0.9	60	0.5

Tabela nr. 17 – Prezantimi tabelar i vlerësimit të të dëgjuarit

Shkalla e vlerësimit MVP të të dëgjuarit nga numri i përgjithshëm i nxënësve është **0.9%**, ndërsa PVP 98.6%. Pasqyra e veçorive patologjike sipas klasëve është paraqitur në *tabelën 17*, ndërsa pasqyra e përgjithshme në *grafikonin nr. 17*.



Grafikoni nr. 17 – Prezantimi grafik i vlerësimit të të dëgjuarit

16. Lëkura dhe mukozat e dukshme

Lëkura dhe mukozat e dukshme								
Shkollat Fillore të Mesme të Ulëta (SHFMU)								
SHFMU	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		PVP		MVP		Mungojnë të dhënat	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Klasat I	1033	100.0	1028	99.5	4	0.4	1	0.1
Klasat II	1032	100.0	1020	98.8	8	0.8	4	0.4
Klasat III	1060	100.0	1051	99.2	3	0.3	6	0.6
Klasat IV	1195	100.0	1182	98.9	8	0.7	1	0.1
Klasat V	1108	100.0	1094	98.7	4	0.4	10	0.9
Klasat VI	1184	100.0	1174	99.2	2	0.2	8	0.7
Klasat VII	1214	100.0	1200	98.8	6	0.5	8	0.7
Klasat VIII	1411	100.0	1394	98.8	10	0.7	7	0.5
Klasat IX	971	100.0	955	98.4	13	1.3	3	0.3
1. Gjithësejtë	10208	100.0	10098	98.9	58	0.6	48	0.5
Shkollat e Mesme të Larta (SHML)								
SHML	Nxënës të përfshirë në vizita sistematike		PVP		MVP		Mungojnë të dhënat	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Klasat X	784	100.0	755	96.3	12	1.5	17	2.2
Klasat XI	885	100.0	860	97.2	22	2.5	3	0.3
Klasat XII	736	100.0	719	97.7	14	1.9	3	0.4
2. Gjithësejtë	2405	100.0	2334	97.0	48	2.0	23	1.0
